



Vëllimi 2, Numri 15

nëntor 2021

# BULETINI KUNDËR TERRORIZMIT

PËR BALLKANIN, RRETH BALLKANIT

## NË KËTË NUMËR

Lajme dhe Informacione kundër terrorizmit 1

Kosovë: Pesë të dyshuar të arrestuar për përgatitjen e akteve terroriste - 2

Bosnje-Hercegovina: Gjykata e Bosnje-Hercegovinës hedh poshtë vendimin e apelit në çështjen e luftëtarëve të huaj terroristë – 2

EUROPOL: Raporti për situatën dhe trendet e terrorizmit në Bashkimin Evropian për vitin 2021 - 3

Teknikat e hetimit të terrorizmit: Operacionet e fshehta, Pjesa I- 3

**Lajme dhe informacione lidhur me terrorizimin për përditësimin dhe komunikimin mes partnerëve tanë në rajon**

*Departamenti i Drejtësisë, Zyra e Ndihmës Zhvillimore dhe Trajnimit Prokurorial (OPDAT) në partneritet me Departamentin Amerikan të e Shtetit, Byroja e Antiterrorizmit*

Në këtë numër do të mësoni se si Kosova ka ndaluar kohët e fundit një komplot terrorist të dyshuar të ISIS-it dhe ka sekuestruar një numër të madh armësh. Do të mësoni gjithashtu rreth një vendimi të kohëve të fundit të departamentit të Apelit në Gjykatën e Bosnjë-Hercegovinës në çështjen e një LHT të kthyer. Më tej, paraqesim një përmbledhje nga raporti më i fundit i Europolit mbi terrorizmin, ndërsa në fund të këtij numri ofrojmë këshilla të dobishme për ndërmarrjen e operacioneve të fshehta të suksesshme.

Tom Saunders

Clay Stiffler

Këshilltarë Ligjorë për Kundërterrorizmin në Ballkan  
OPDAT/DOJ; Ambasada e SHBA, Sarajevë OPDAT/DOJ; Ambasada e SHBA, Tiranë  
[SaundersTN@state.gov](mailto:SaundersTN@state.gov) [StifflerRC@state.gov](mailto:StifflerRC@state.gov)

Jasenska Ferizović, Këshilltare Ligjore  
OPDAT/DOJ; Ambasada e SHBA, Sarajevë OPDAT/DOJ; Ambasada e SHBA, Tiranë  
[FerizovicJ@state.gov](mailto:FerizovicJ@state.gov)

Bledar Bashanović, Specialist Ligjor  
OPDAT/DOJ; Ambasada e SHBA, Sarajevë OPDAT/DOJ; Ambasada e SHBA, Tiranë  
[BashanovicB@state.gov](mailto:BashanovicB@state.gov)

## Kosovë: Pesë të dyshuar arrestohen për përgatitjen e akteve terroriste

Policia dhe Prokuroria Speciale e Kosovës ndaluan një celulë të dyshuar terroriste më 10 tetor 2021. Anëtarët e kësaj celule dyshohen për përgatitjen e disa akteve terroriste. Organet e zbatimit të ligjit sekuestruan shumë armë, duke përfshirë granata dore, eksplozivë, armë zjarri, një dron dhe një raketëdhënëse. Sipas burimeve mediatike, hetimi zgjati tre muaj, u zhvillua në fshehtësi të madhe dhe përfshiu përdorimin e masave të posaçme të hetimit dhe mbikëqyrjes për monitorimin dhe ndjekjen e aktiviteteve të të dyshuarve.



*Armët e sekuestruara gjatë operacionit të policisë*

I dyshuari Ardian Gjuraj dyshohet se është udhëheqësi dhe instruktori i grupit. Anëtarët e tjerë të dyshuar të grupit janë Nuhredin Skenderi, Ergim Sylja, Mentor Bellaqa dhe Shkodran Krasniqi. Sipas urdhrimit hetimor të cituar nga mediat e Kosovës, Gjuraj i kishte ngjitur shkallët duke u bërë zyrtar i rangut të lartë në zyrën e marrëdhënieve me jashtë të ISIS-it dhe kishte marrë udhëzime se si të ndërtohet një rrjet terrorist në vend. Mediat raportojnë se të pandehurit kanë tentuar të blejnë armë nga policia e Kosovës gjatë një operacioni të fshehtë.

Ardian Gjuraj ishte dënuar më parë me një vit e pesë muaj burg për terrorizëm në shkurt të vitit 2018. Pesë muaj më vonë, ishte liruar nga Gjykata e Apelit.

Të gjithë të pandehurit u lanë në paraburgim për 30 ditë nga Departamenti Special i Gjykatës Themelore të Prishtinës ndërkohë që vazhdojnë hetimet.

**Burimet:** <https://kallxo.com/lajm/detaje-grupi-radikal-islamik-planifikonte-sulme-terroriste-ne-kosove/>

<https://kallxo.com/lajm/dosja-e-prokurorise-sa-zgjati-hetimi-per-grupin-e-dyshuar-terrorist/>

<https://kallxo.com/lajm/detaje-se-si-ishin-ndare-rolet-e-grupit-te-dyshuar-terrorist-per-pergatitjen-e-sulmeve-ne-kosove/>

## Bosnje-Hercegovina: Gjykata e Bosnje-Hercegovinës hedh poshtë vendimin e apelit në çështjen e luftëtarëve të huaj terroristë

Në shtator 2021, Gjykata e Bosnjë-Hercegovinës dha vendimin në shkallën e apelit për çështjen e luftëtarit të huaj terrorist Milarem Berbić, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe duke konfirmuar dënimin me 3 vjet burg të të pandehurit. Berbić u dënua më 19 maj 2021 për veprën penale të themelimit të një organizate të huaj paraushtarake ose parapolicore dhe anëtarësimi në të. I pandehuri ishte larguar nga Bosnjë-Hercegovina në vitin 2014 dhe kishte udhëtuar për në Siri. Gjatë qëndrimit në Siri, ai kishte ndihmuar ISIL-in dhe kishte luftuar për të si anëtar i njësisë së udhëhequr nga Goran Pavlović. Në apel, i pandehuri pretendoi se gjykata duhet ta hidhte poshtë vendimin e gjykatës më të ulët, kurse prokurori kërkoi që dënimi me 3 vjet burg të rritej, pasi ishte i pamjaftueshëm. Megjithatë, Gjykata e apelit i hodhi poshtë argumentet e të dyja palëve dhe e la në fuqi vendimin.

**Burimi:** [Potvrđena prvostepena presuda Milaremu Berbiću za ratovanje u Siriji](#)

# EUROPOL: Raporti për situatën dhe trendet e terrorizmit në Bashkimin Evropian për vitin 2021

I publikuar në muajin qershor, Raporti i situatës dhe trendeve të terrorizmit në Bashkimin Evropian (BE) i Europolit jep një pasqyrë të sulmeve terroriste dhe arrestimeve në vitin 2020 në BE, në Britaninë e Madhe dhe në Zvicër.

Sipas Raportit, janë realizuar, kanë dështuar dhe janë parandaluar 57 sulme terroriste gjithsej në BE në vitin 2020, me 21 persona të vrarë dhe 54 të plagosur. Përveç kësaj, në 2020-ën janë raportuar 62 incidente terroriste nga Britania e Madhe. Sipas raportit, numri i sulmeve terroriste që janë realizuar ka qenë më i madh se ai i sulmeve të parandaluara në vitin 2020. Të 15 sulmet terroriste në BE (10), Zvicër (2 sulme të mundshme terroriste) dhe në Britaninë e Madhe (3) janë kryer nga persona që veprojnë të vetëm dhe me prejardhje të ndryshme, ku shumica kanë përdorur metoda jo të sofistikuara sulmi. Një numër i konsiderueshëm i këtyre autorëve kanë qenë persona të liruar nga burgu ose të burgosur, gjë që tregon efektet e radikalizimit dhe rekrutimit xhihadist në burgje, si dhe kërcënimin që vjen nga të burgosurit e liruar. Kthimi i luftëtarëve të huaj terroristë në Evropë në vitin 2020 u prek nga kufizimet e vendosura ndaj udhëtimeve për shkak të COVID-19, si rrjedhojë e të cilave qindra evropianë mbetën në kampet e paraburgimit në Sirinë verilindore. Përveç kësaj, heqja e shërbimit të mesazheve Telegram në 2019-ën e zvogëlua në mënyrë të konsiderueshme komunikimin dhe operimin në rrjet të xhihadistëve.

Në vitin 2020, u arrestuan 254 persona të dyshuar për kryerje të veprave penale të lidhura me xhihadizmin, që përbën një rënie prej më shumë se 50%. Vepra më e shpeshtë penale që ka cuar në arrestime ka qenë anëtarësimi në grupe terroriste, pasuar nga shpërndarja e propagandës dhe planifikimi/përgatitja e akteve terroriste, dhe lehtësimi dhe financimi i terrorizmit.

Shumica e ndjekjeve penale të veprave terroriste të ndërmarra në Shtetet Anëtare të BE-së në vitin 2020 (314 nga 422) ishin të lidhura me terrorizmin xhihadist, veçanërisht me

veprat që lidhen me konfliktin në Siri dhe me aktivitetet e organizatave terroriste që veprojnë në atë zonë, kryesisht ISIS.

Raporti vëren më tej se të paktën pesë sulme xhihadiste që kishin ndodhur në Evropë në vitin 2020 përfshinin autorë që më parë kishin qenë në burg, gjë që tregon se Evropa vazhdoi të vuajë efektet e radikalizimit dhe rekrutimit xhihadist në burgje dhe kërcënimin nga të burgosurit e liruar.

Në lidhje me propagandën xhihadiste në internet, raporti vëren se ajo ka filluar të shpërndahet edhe më shumë përmes një shumëllojshmërie platformash pas heqjes nga shërbimi të Telegramit në 2019-ën dhe se mbështetësit e ISIS-it kanë vazhduar dukshëm të luftojnë për të rindërtuar rrjetet e tyre dhe për t'u siguruar që mesazhet e ISIS-it të arrijnë audiencën e synuar. Edhe pse sasia dhe cilësia e propagandës së prodhuar nga mediat zyrtare të ISIS-it u ulën ndjeshëm në 2020-ën, mbështetësit e ISIS-it vazhduan të përdorin platforma të shumta online për të propaganduar ideologjinë e tyre dhe për të nxitur sulme të aktorëve të vetmuar në vendet perëndimore. Edhe rrjeti i Al-Kaedas vazhdoi të ruajë një prani të vazhdueshme propagandistike në internet në 2020-ën.

Sipas raportit, në vitin 2020 u realizua një sulm terrorist nga një ekstremist i djathtë, kurse tre sulme të tjera dështuan ose u parandaluan. Tridhjetë e katër persona u arrestuan me dyshimin për përfshirje në aktivitete terroriste të ekstremizmit të djathtë. Të dyshuarit e arrestuar për planifikim sulmesh terroriste ose sulmesh ekstremiste kanë lidhje me komunitetet e dhunshme transnacionale online. Raporti gjithashtu vë në dukje se ekstremistët e djathtë përdorin video games dhe platforma lojrash për të propaganduar ideologjinë e tyre. Numri i dënimeve për terrorizëm ekstremist të djathtë u rrit në vitin 2020 në krahasim me 2019-ën.

Në lidhje me sulmet terroriste të ekstremizmit të majtë dhe sulmet terroriste anarkiste, raporti konstaton se shifrat për vitin 2020 vazhduan të ishin të krahasueshme me ato të viteve të mëparshme, kurse numri i arrestimeve ra më shumë se gjysma e numrit të mëparshëm. Në vitin 2020, ndjekjet penale për veprat e terrorizmit të ekstremizmit të majtë dhe terrorizmit anarkist ishin lloji i dytë më i zakonshëm i ndjekjeve penale të terrorizmit në BE.

**Burimi:** [Raporti për situatën dhe trendet e terrorizmit në BE në vitin 2021](#)

## Këshilla praktike

### Teknikat e hetimit të terrorizmit: Operacionet e fshehta,

Temat për seksionin e këshillave praktike për këtë numër dhe për numrin e ardhshëm të buletinit do të jenë operacionet e fshehta. Në këtë numër do të përshkruajmë shkurtimisht disa lloje operacionesh të fshehta dhe pika të rëndësishme që agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të marrin në konsideratë përpara se ta përdorin këtë teknikë. Në numrin e ardhshëm, do t'ju ofrojmë disa këshilla praktike për kryerjen me sukses të projekteve të fshehta.

Operacionet e fshehta përkufizohen si një teknikë hetimore, ku oficerët e zbatimit të ligjit veprojnë fshehurazi me qëllim zhvillimin e provave për veprimtaritë e paligjshme. Në një operacion të fshehtë, një ose më shumë oficerë të fshehtë vihen në një pozicion që jep mundësi të japin informacion të drejtpërdrejtë rreth veprimtarisë kriminale dhe të dëshmojnë si dëshmitarë të drejtpërdrejtë kundër një subjekti ose një komploti kriminal. Qëllimet e operacioneve të fshehta mund të

ndryshojnë ndjeshëm nga një operacion në tjetrin, duke filluar nga një kontakt i thjeshtë i infiltruar, përmes të cilit mblidhen informacione të natyrës së inteligjencës e deri në projekte tejet të sofistikuara që përfshijnë disa hetues njëherësh.

Operacionet e fshehta kanë disa avantazhe. Së pari, ato mund të prodhojnë rezultate spektakolare që nuk mund të përftohen nëpërmjet teknikave të tjera të hetimit. Së dyti, ndryshe nga shumica e metodave që përdoren për zgjidhjen e krimeve të kryera, operacionet e fshehta mundësojnë zbatimin e ligjit në mënyrë proaktive dhe duke parandaluar krime që nuk kanë ndodhur akoma. Së treti, për shkak të pozicionit të tyre zyrtar dhe trajnimit, oficerët e zbatimit të ligjit konsiderohen dëshmitarë më të dëshirueshëm në gjykatë sesa informatorët ose qytetarët e zakonshëm bashkëpunues.

Megjithatë, operacionet e fshehta janë në të njëjtën kohë edhe jashtëzakonisht komplekse dhe kërkojnë shumë kohë dhe njerëz, janë të rrezikshme dhe potencialisht të dëmshme psikologjikisht për oficerin e fshehtë dhe për jetën e tij personale.

Ekzistojnë në thelb tre lloje operacionesh të fshehta: operacionet me kontakte të kufizuara, operacione me infiltrim gjysme të thelluar dhe operacione me infiltrim të thellë.

Në operacionet me **kontakte të kufizuara ose operacionet e fshehta “me një të shtënë”**, një oficer i fshehtë ndërmerr “një ose disa kontakte të shkurtra me një subjekt ose me një person tjetër që ka dijeni për një gjë të caktuar me qëllim mbledhjen e informacioneve ose provave” pa zbuluar identitetin e tij si oficer. Një operacion i tillë mund të përfshijë pjesëmarrjen në një takim, angazhimin e një personi në një bisedë, vizitën në një vend të caktuar etj. Megjithëse ky lloj operacioni i fshehtë zakonisht është afatshkurtër, ai duhet të jetë gjithsesi i planifikuar dhe i dokumentuar mirë.

Në një **operacion me infiltrim gjysmë të thelluar**, oficeri i fshehtë “merr kontakte në një zonë të caktuar me një shkallë të caktuar frekuence, por nuk operon aty gjatë gjithë kohës”. Në këtë lloj projekti, oficeri i fshehtë duhet të ketë mjete cilësore për të mbështetur identitetin e tij të rremë, duke përfshirë dokumentacionin e rremë personal dhe të automjetit, dhe nganjëherë edhe një vendbanim ose punësim të rremë që subjekti mund ta shohë nëse është e nevojshme.

**Operacioni me infiltrim të thelluar** është niveli më kompleks i punës së infiltrimit. Kjo është detyrë me kohë të plotë, ku një oficer i infiltruar bashkohet me subjektin ose konspiracionin e synuar me kohë të plotë. Kjo do të thotë se oficeri i infiltruar thellë nuk duhet të kryejë punë të tjera policore dhe se agjencia e zbatimit të ligjit nuk duhet ta përdorë atë për të kryer njëkohësisht edhe funksione të tjera të fshehta në raste të ndryshme, përveç atyre që kanë të bëjnë me të njëjtin lloj krimi dhe që mund të jenë plotësuese të rastit të synuar.

Siç është theksuar më sipër, operacionet e fshehta janë shumë komplekse dhe “përfshijnë shumë më shumë sesa një hetues që u prezantohet të tjerëve ndryshe nga kush është në të vërtetë”. Për këtë arsye, agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të peshojnë tërësisht anët pro dhe kundra përpara se ta përdorin këtë teknikë hetimi, duke marrë parasysh veçanërisht këto pika:

**A janë shteruar të gjitha teknikat e tjera të hetimit?** Nëse të njëjtët objektiva mund të arrihen me teknika më pak kërkuese, atëherë operacionet e fshehta nuk duhet të përdoren.

**A kemi të bëjmë me një situatë emergjente?** Situatat ku mund të vihet në rrezik jeta e njerëzve mund të kërkojnë fillimin e një operacioni të fshehtë. Për shembull, nëse një grup ekstremist po përpiqet të gjejë eksplozivë për të bombarduar një objektiv, një oficer i fshehtë mund të marrë rolin e një ofruesi eksplozivësh, në mënyrë që këtë kërkesë të mos e plotësojë dikush tjetër.

**A ka një person të përshtatshëm dhe të disponueshëm që mund ta marrë përsipër këtë rol të fshehtë?** Operacionet e fshehta janë unike dhe kërkojnë aftësi të caktuara dhe talente që shumë njerëz nuk i kanë dhe madje edhe hetuesit që posedojnë cilësi të tilla mund të mos jenë në gjendje ose mund të mos jenë personat e përshtatshëm për të marrë pjesë në detyra të fshehta për arsye të tjera (për shembull, për shkak të ndikimit negativ që operacione të tilla mund të kenë në jetën e tyre familjare, për shkak se njihen si zyrtarë të zbatimit të ligjit ose për shkak se ata kanë përgjegjësi të tjera të specializuara brenda agjencisë së tyre të zbatimit të ligjit. Në cdo rast, ndoshta është më mirë që të lihet projekti sesa të përdoret një operativ i papërshtatshëm për një rol të fshehtë.

**A mundet agjencia të ruajë sigurinë e plotë të operacionit?** Për operacionin e fshehtë nuk duhet të kenë njohuri në departament dhe as në prokurori. Specifikat e operacionit të fshehtë duhet t'u bëhen të ditura vetëm personave që është e domosdoshme të jenë në dijeni për to.

**A është agjencia në gjendje ta mbrojë oficerin e fshehtë?** Agjencia e zbatimit të ligjit duhet të bëjë një vlerësim të mirë të asaj që kërkohet për ta përmbushur këtë angazhim sepse “sa më i rrezikshëm të jetë objektivi, aq më shumë mbrojtje mund të duhet për hetuesin e fshehtë”. Sigurimi i oficerit të fshehtë mund të kërkojë marrjen e një sërë masash paraprake si mbikëqyrja, mbulimi elektronik, madje edhe caktimi i zyrtarëve shtesë për të funksionuar në role të tjera të fshehta.

**A është agjencia në gjendje të përballet me pasojat?** Nëse rezulton se një agent i fshehtë dhe familja e tij janë në rrezik, ose në qoftë se kompromentohet funksionimi i mëtejshëm i agentit të fshehtë si zyrtar i zbatimit të ligjit, agjencia përkatëse e zbatimit të ligjit duhet të jetë e gatshme ta transferojë operativin e fshehtë larg zonës ku është ndërmarrë projekti i fshehtë.